



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA JURIDIKE DHE PËRPUTHSHMËRISË SË STANDARDEVE  
SEKTORI I PROKURIMEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

**07.08.2024**

Drejtuar: **Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “LENI-ING” SHPK & “ANGERBA” SHPK  
Shkoder Puke Rruga "Rexhep Teni", Lagjja e poshtme, Blloku Nr.3, Ndertesa Nr.46/1.**

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar - Shërbime - Prokurim me mjete elektronike**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-12906-07-11-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Supervizion punimesh Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior, Loti 1 (2024)”, me fond limit: 1,626,223.81 (një milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e dyqind e njëzet e tre pikë tetëdhjetë e një) Lekë, pa TVSH.**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **6 muaj**

Publikimet e mëparshme: **Data 15 Korrik 2024, Nr. 37**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

**oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto**

Sipas rëndësisë:

Çmimi  pikët 50

Propozimi Teknik  pikët 50

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. OE “ZENIT&CO” SHPK**

**K61731002D**

Vlera: **1,561,174.00** (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **270,00**

**2. BOE “NET-GROUP” SHPK + “UNITEC-STUDIO” SHPK**

**L72023002P / K72316010C**

Vlera: **1,470,000.00** (një milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

**3. BOE “NOVATECH STUDIO” SHPK**

**L01717030C**

Vlera: **1,417,012.12** (një milion e katërqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dymbëdhjetë pikë dymbëdhjetë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

**4. BOE “LENI-ING” SHPK & “ANGERBA” SHPK**

**J88730334W / L01322018T**

Vlera: **1,471,719.00** (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **279,00**

**5. BOE “TAULANT” SHPK & “E.B.S” SHPK**

**K61617040L / K72014002P**

Vlera: **1,500,000.00** (një milion e pesëqind mijë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

**6. BOE “ALBEGIS&CO” SHPK & “DERBI-E” SHPK**

**K51518007R / K77916947A**

Vlera: **1,138,600** (një milion e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “ALBEGIS&CO” SHPK & “DERBI-E” SHPK, me Numër Nipti: **K51518007R / K77916947A**, pasi oferta ekonomike me vlerë 1,138,600 (pa tvsh), e paraqitur nga ky operator është poshtë vlerës minimale të lejuar 1,417,010.56 (pa tvsh) kjo, në kundërshtim me Vendimin Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” dhe Rekomandimin Nr. 5585, datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik”**

---

**2. Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “TAULANT” SHPK & “E.B.S” SHPK, me Numër Nipti: **K61617040L / K72014002P**, pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST, konkretisht;**

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1. BOE duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 20 %** e vlerës së përlogaritur e kontratës (vlera e fondit limit).

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.4. BOE nuk disponon stafin e nevojshëm mbikëqyrës për realizimin e kësaj kontrate pasi stafi i propozuar për këtë procedurë është i angazhuar në kontratë tjetër në proces ndërtimi të lidhur me Autoritetin Rrugor Shqiptar kjo në kundërshtim me pikën: **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

---

**3. Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “NOVATECH STUDIO” SHPK, me Numër Nipti: **L01717030C**, pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST, konkretisht:**

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.4. OE nuk disponon stafin e nevojshëm mbikëqyrës për realizimin e kësaj kontrate pasi stafi i propozuar për këtë procedurë është i angazhuar në kontratë tjetër në proces ndërtimi të lidhur me Autoritetin Rrugor Shqiptar kjo në kundërshtim me pikën: **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

---

**4. Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NET-GROUP” SHPK + “UNITEC-STUDIO” SHPK, me Numër NIPTI **L72023002P / K72316010C**, pasi nuk**

***ka arritur te paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST, konkretisht:***

Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin mbikëqyrës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), sipas kërkesave të DST.

***-Stafi i paraqitur nga bashkimi i operatorëve nuk është në përputhje me përqindjen e përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit, kjo, në kundërshtim me nenin 88 “Bashkimi i Operatoreve ekonomike”, VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 pika 3 “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.***

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE “LENI-ING” SHPK & “ANGERBA” SHPK**, me adresë: **Shkoder Puke Rruga "Rexhep Teni", Lagjja e poshtme, Blloku Nr.3, Ndertesa Nr.46/1**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **1,471,719.00** (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë) **Lekë pa TVSH** / totali i pikëve të marra **279,00** është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Gentian Gjyli**